2254/26 26 MAY 2026

	ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА **KOMUNA E GRAÇANICËS** **MUNICIPALITY OF GRACANICA**	

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.28/2008), nenit 5 paragrafi 2 të Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.31/2008), Ligjit nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.13/2012), Ligjit nr.05/L-009 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.04/L-111 ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.10/2015), nenit 48 paragrafi 3 të Statutit të Ndërmarrjes publike-komunale "Ekologjia" SH.A. Graçanicë (Nr.5754/17 i datës 06.09.2017), Kuvendi i Komunës së Graçanicës në mbledhjen e tretë të jashtëzakonshme, e mbajtur më datën 26.05.2026, merr këtë:

VENDIM Nr.32/2026/KG

për dhënien e pëlqimit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Ndërmarrjes publike-komunale "Ekologjia" SH.A. Graçanicë (Nr.5754/17 i datës 06.09.2017)

Neni 1

Jepet pëlqimi për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Ndërmarrjes publike-komunale "Ekologjia" SH.A. Graçanicë (Nr.5754/17 i datës 06.09.2017), të miratuar nga Komisioni Komunal i Aksionarëve dhe propozuar nga kryetari i Komisionit Komunal të Aksionarëve nr.2099/26 të datës 14.05.2026.

Neni 2

Në Statutin e Ndërmarrjes publike-komunale "Ekologjia" SH.A. Graçanicë, në nenin 14, paragrafi 3 ndryshon si në vijim:

"Komisioni Komunal i Aksionarëve përbëhet nga tre anëtarë:
1. Sasha Daniq (***Saša Danić***), me propozim të kryetarit të komunës,
2. Marija Steviq (***Marija Stević***), me propozim të Kuvendit komunal (KK),
3. Dejan Bozhidareviq (***Dejan Božidarević***), me propozim të Kuvendit komunal (KK)".

Në nenin 18, paragrafi 6 ndryshon si në vijim:

"Sipas vendimit të Komisionit Komunal të Aksionarëve, të regjistruar me numër 2070/23 të datës 15.05.2023, katër (4) drejtorë të Bordit të NPK „Ekologjia" SH.A. janë:

1. Marija Sllaviq (***Marina Slavić***);
2. Alleksandra Smiljiq (***Aleksandra Smiljić***);
3. Dejan Stanojeviq (***Dejan Stanojević***);
4. Aziz Karadollami (***Aziz Karadolami***).

Anëtari i pestë i Bordit të drejtorëve, sipas funksionit të Drejtorit ekzekutiv, është:

5. Sllagjana Mirkoviq (***Slađana Mirković***)".

Në nenin 27, paragrafi 2 ndryshon si në vijim:

"Në bazë të vendimit të Bordit të drejtorëve të NPK "Ekologjia", të regjistruar me numër 181/2026 të datës 11.03.2026, si Drejtor ekzekutiv i ndërmarrjes është emëruar Sllagjana Mirkoviq (***Slađana Mirković***), me numër personal: _____.
Personi i autorizuar i NPK "Ekologjia" SH.A. Graçanicë është Drejtori ekzekutiv - "Sllagjana Mirkoviq (***Slađana Mirković***)".

Neni 3

Statuti i Ndërmarrjes publike-komunale "Ekologjia" SH.A. Graçanicë (Nr.5754/17 i datës 06.09.2017) në pjesën tjetër mbetet i pandryshuar.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 30 ditë pas dorëzimit tek autoriteti mbikëqyrës në kuptimin e nenit 8 lidhur me nenin 9 të Ligjit nr. 08/L-284 për shqyrtimin administrativ të aktevetë komunave dhe pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević